



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 217, datë 22.10.2019

PËR DEKLARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT PËR ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 283, të ligjit nr. 115/2016, “*Për Organet e Qeverisjes Vendore së Sistemit të Drejtësisë*” dhe në nenin 168, të ligjit nr. 96/2016, “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, pasi shqyrtoi Raportin e Komisionit të Përkohshëm të Vlerësimit të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i ngritur me vendimin nr. 59, datë 24.04.2019, të këtij Këshilli, lidhur me inspektoren {...}, në përfundim,

VËREN

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 59, datë 24.04.2019, ngriti Komisionin e Përkohshëm të Vlerësimit të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili kishte për detyra të evidentojë:

- a) inspektorët, veprimtaria e të cilëve ka qenë në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësi lidhur me vlerësimin profesional dhe etik të gjyqtarëve;
- b) inspektorët, veprimtaria e të cilëve ka qenë në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësi lidhur me trajtimin e ankesave dhe hetimin disiplinor të gjyqtarëve;
- c) inspektorët të cilët gëzojnë statusin e magjistratit dhe cilët ndër inspektorë nuk e gëzon këtë status.
- d) inspektorët të cilët janë emëruar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë duke u përzgjedhur ndërmjet gjyqtarëve që përmbushin kriteret për t’u emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit;

- e) inspektorët të cilët janë emëruar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë duke u përzgjedhur, ndërmjet juristëve që kanë shërbyer si gjyqtar jo më pak se 5 vjet;
- f) dhënia e pëlqimit nga secili inspektorë për të vijuar ushtrimin e veprimtarisë pranë KLGJ-së deri në krijimin e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në zbatim të këtyre detyrave Komisioni i Përkohshëm të Vlerësimit të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë verifikoi dhe konstatoi se:

Inspektorja {...} ka lindur në Korçë, më datë 10.03.1980. Është diplomuar juriste në Fakultetin e Drejtësisë, pranë Universitetit të Tiranës në vitet akademike 1999-2003. Më pas, ajo ka përfunduar edhe Shkollën e Magjistraturës në vitet akademike 2003-2006. Pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës Znj. {...} është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me dekretin nr. 5107, datë 06.11.2006, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe ka punuar në këtë detyrë deri në datën 05.07.2013. Për këtë periudhë ajo ka pasur vlerësime profesionale për vitet 2007-2009 dhe 2010-2012, duke u vlerësuar shumë mirë 3+ në të tre grup kriteret.

Nga verifikimi pranë Protokollit të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, rezulton se nga ana e znj. {...} janë depozituar ndër vite 10 (dhjetë) kërkesa të saj, drejtuar këtij këshilli për emërimin e saj si gjyqtare në pozicionet e shpalluara të lira. Konkretisht, kërkesat si gjyqtare janë të datave: 03.05.2010; 25.02.2011; 05.01.2012; 01.10.2012; 26.11.2012; 03.01.2013; 24.06.2013; 08.05.2014; 18.07.2016 dhe 09.11.2016.

Me vendimin nr. 345, datë 05.07.2013, të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë ajo është emëruar në detyrën e inspektore, ndërsa në datën 29.06.2018, i është zgjatur mandati deri në krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke punuar në Seksionin e Inspektimit dhe Verifikimit të Ankesave, detyrë të cilën e ka kryer deri në muajin tetor të vitit 2017. Aktualisht kryen detyrën e Inspektore/Nëpunëses përgjegjëse për vlerësimin profesional të gjyqtarëve, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*. Gjatë kryerjes së detyrës së inspektore, Znj. {...} ka pasur vlerësime profesionale për periudhën 05.07.2013 - 31.12.2014, duke u vlerësuar shumë mirë 4+ në të katër grup kriteret.

Znj. {...} ka punuar në Seksionin e Inspektimit dhe Verifikimit të Ankesave dhe që prej muajit tetor të vitit 2017 kryen detyrën e Inspektore/Nëpunëses përgjegjëse për vlerësimin profesional të gjyqtarëve, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*.

Inspektorja {...} me shkresën nr. 2732/18 prot., datë 17.05.2019 ka dhënë pëlqimin për të vazhduar ushtrimin e detyrës së Inspektore/Nëpunësit përgjegjës në Njësinë Mbështetëse të ngritur pranë Komisionit përkatës për vlerësimin profesional pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor,

ku ruhet statusi i magjistratit, si dhe paga e gjyqtarit të apelit. Asaj i ka mbaruar mandati 5 vjeçar i dhënë nga ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Ligji nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” në nenin 283, paragrafi 9, i tij parashikon se:

Në ditën e krijimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë pushon së zhvilluari veprimtaria e inspektimit, pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe përfundon mandati i Kryeinspektorit.

Edhe pika 10 e të njëjtës dispozitë parashikon se:

Në ditën e krijimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryeinspektori dhe inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të cilët janë magjistratë, si dhe prokurorët që ushtrojnë veprimtarinë e tyre për përgjegjësinë disiplinore të prokurorëve pranë Zyrës së Prokurorisë së Përgjithshme do të konsiderohen si inspektorë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për një periudhë 6-mujore nga data e krijimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë. Në përfundim të kësaj periudhe ata do të vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë nëse plotësojnë kërkesat dhe kriteret për inspektor sipas parashikimeve të këtij ligji. Në këtë rast, mandati i tyre si inspektorë fillon me emërimin si inspektor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë ose Prokurorinë e Përgjithshme. Në rast se ata nuk i përmbushin kërkesat dhe kriteret, ata kanë të drejtën e rikthimit në pozicionin e mëparshëm 6 muaj pas krijimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ose të marrin pjesë në procedurat e transferimit dhe lëvizjes paralele, sipas rregullave të parashikuara në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ligji nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 168, paragrafi 1, parashikon se:

Inspektori dhe Kryeinspektori në detyrë, të cilët kanë statusin e gjyqtarit dhe ushtrojnë funksionet në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji konsiderohen magjistratë dhe ndaj tyre zbatohen dispozitat e këtij ligji. Ata i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në nenin 3/10, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është parashikuar se: *Organ i vlerësimit të aftësive profesionale është Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili ka funksionuar sipas ligjin nr. 8811, datë 17.05.2011, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.*

Neni 14 e vijues të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, parashikon se:

1. Inspektoriati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë përbëhet nga Kryeinspektori dhe inspektorët. Rregullat e organizimit dhe të funksionimit dhe numri i inspektorëve përcaktohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

2. Kryeinspektori dhe inspektorët emërohen dhe shkarkohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozimin e Zëvendëskryetarit.

3. Kandidaturat e inspektorëve përzgjidhen, pas shpalljes publike, ndërmjet gjyqtarëve që përmbushin kushtet për t'u emëruar gjyqtarë në Gjykatat e Apelit dhe, në mungesë të tyre, ndërmjet juristëve që kanë shërbyer si gjyqtarë jo më pak se 5 vjet.....

Ndërsa neni 15, i ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar parashikon se:

1. Inspektorët emërohen në këtë detyrë për një afat 5-vjeçar, me të drejtë riemërimi.

2. Periudha e ushtrimit të funksionit të inspektorit njihet si periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar për efekt të kërkesave të karrierës profesionale. Gjyqtarët, që shërbejnë si inspektorë në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me kërkesë të tyre, riemërohen gjyqtarë pa konkurs.

3. Kryeinspektori përfiton pagë të njëjtë me Kryetarin e Gjykatës së Apelit të Tiranës, ndërsa inspektorët përfitojnë pagë të njëjtë me gjyqtarët e kësaj gjykate.

Ligji nr. 9877, datë 18.02.2008, "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor", i ndryshuar me ligjin nr. 114/2013, datë 11.4.2013, në nenin 28, të tij ku bën fjalë për ruajtjen e statusit të gjyqtarëve që shërbejnë në institucione të tjera, parashikon se:

1. Gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmës ligjor ose këshilltar i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të gjykatës së apelit, prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës.

2. Trajtimi financiar i gjyqtarëve gjatë kësaj periudhe bëhet nga institucionet përkatëse, duke i dhënë pagën më të lartë ndërmjet dy pagave.

3. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion si gjyqtar, për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale.

4. *Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion edhe për ata gjyqtarë, të cilët kanë shërbyer në institucionet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, para hyrjes në fuqi të këtij ligji.*

Inspektorja {...} pas dorëheqjes nga funksioni i gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në datë 05.07.2013, është emëruar në detyrën e inspektores pranë ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndërsa në datën 29.06.2018 i është zgjatur mandati si inspektore.

Duke qenë se, inspektorja {...} ka kaluar direkt nga detyra e gjyqtares në detyrën e inspektores, pranë ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në zbatim të nenit 28, të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2013, datë 11.04.2013 rezulton se nuk e ka humbur statusin e gjyqtarit pas largimit nga detyra e gjyqtares dhe për rrjedhojë në kohën kur ajo është emëruar si inspektore në ish Këshillin e Lartë të Drejtësisë e ka patur këtë status. Po ashtu, inspektorja e ruan statusin e gjyqtarit sepse detyra që ka ushtruar pranë KLD e ka gëzuar këtë status për shkak të ligjit. Ajo ka bërë disa kërkesa të punojë përsëri gjyqtare pas mandatit të parë si inspektore dhe me vendim të ish-KLD asaj i është zgjatur mandati i inspektores deri në krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ajo i ka shfaqur pëlqimin Komisionit të Përkohshëm të Vlerësimit të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë të punojë me njësinë e vlerësimit etik dhe profesional pranë K.L.GJ-së me statusin e magjistratit.

Nga citimi i fakteve dhe dispozitave ligjore të mësipërme rezulton e provuar se, inspektorja {...} në momentin që është marrë vendimi nr. 345, datë 05.07.2013 nga ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë, për emërimin e saj në detyrën e inspektores ka qenë në detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe ka patur në këtë detyrë më shumë se gjashtë vjet, duke plotësuar kështu kërkesat e ligjit për t’u emëruar si gjyqtare në gjykatën e apelit. Meqenëse ajo nuk është shkëputur për asnjë moment nga detyra e gjyqtares dhe është emëruar në detyrën e inspektores, duke qenë një nga kandidatët e ardhur nga radhët e gjyqtarëve, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se ajo nuk e ka humbur statusin e gjyqtarit.

Nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor ajo ka punuar në strukturën e re të miratuar nga Këshilli, në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik e Gjyqtarëve me një përbërje 5+1, duke krijuar një përvojë të mirë në këtë drejtim, siç tregojnë edhe rezultatet e vlerësimeve të tyre, të cilat janë evidentuar në relacionet që janë dorëzuar, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Prandaj Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se inspektorja {...} duhet të vazhdojë të punojë në këtë strukturë deri në krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Për sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në përfundimin se, inspektorja {...} e ka ruajtur statusin e gjyqtarit, prandaj asaj duhet t’i konfirmohet statusi i magjistratit, duke vijuar komandimin në detyrën e nëpunësit përgjegjës në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të

Gjyqtarëve, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor deri krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke u bazuar në nenin 283, të ligjit nr. 115/2016, “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*” dhe nenin 168/1, të ligjit nr. 96/2016, “*Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë pasjen e statusin “Magjistrat” për znj. {...}.
2. Znj. {...} të vijojë komandimin në detyrën e nëpunësit në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, deri në krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR